

Në kuadrin e aktiviteteve mësimore të zhvilluara nga Njësia Bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit, në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Akumn-it, u organizua një vizitë me karakter edukativ në Parkun Kombëtar Arkeologjik të Antigonesë.

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me atraksione kulturore, si potenciale të rëndësishme për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Qarkun e Gjirokastrës.

Parku Kombëtar Arkeologjik i Antigonesë është vendbanimi antik më i rëndësishëm në Luginën e Drinos dhe ofron potenciale të shumta për zhvillimin e turizmit alternativ si: turizmi kulturor, historik, edukativ arkeologjik, por dhe turizmit rural, natyror, ekoturizmit, agroturizmit, kulinarisë etj.

Ky aktivitet synoi të rrisë ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e atraksioneve kulturore dhe natyrore si potenciale për zhvillimin e qëndrueshëm të destinacioneve turistike.

Në aktivitet morën pjesë studentë të programeve Bachelor Turizëm dhe Menaxhimi i Turizmit të Qëndrueshëm.



